



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



## KUVENDI I KOMUNËS

KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

01.NR. 06-4926/17

KLINË, 89.2017

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

I SEANCËS SË IX TË KPF-së, MBAJTUR, MË 8.9.2017, NË ORËN 10,00, NË SALLËN E KK

Në seancë prezantuan: kryesuesi i KPF-së, Dr. Haxhi Ibishi, anëtarët e KPF-së, drejtorë të drejtoreve, Zyra ligjore, OSBE, OJQ "Koha", mediet etj.

Seancën e udhëhoqi kryesuesi i KPF=së, Dr. haxhi Ibishi, i cili fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe ju dëshiroi mirëseardhje në këtë seancë të fundit të KPF-së për këtë legjislaturë.

"Hapi mbledhjen e rregullt dhe të fundit për këtë legjislaturë. "Ju falënderoj për bashkëpunimin dhe kontributin që keni dhënë gjithherë në shërbim të qytetarëve të komunës sonë. Urojmë që legjislatura e ardhshme të jetë më e suksesshme dhe më efikase, të përmirësojë aty ku ne kemi gabuar. Të jetë më e mirë dhe më profesionale", pohoi kryesuesi Ibishi.

Kryesuesi hapi debatin rrëth rendit të ditës.

Nuk pati debate.

Kryesuesi vuri në miratim rendin e ditës.

**Me vota unanime u miratua ky**

## RENDI I DITËS

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së KPF-së,
3. Shqyrimi i Draft-buxhetit të Komunës së Klinës për vitin 2018-2010,
4. Shqyrimi i Projekt – rregullores për varreza, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre,
5. Të ndryshme.

Pika e parë: Arsyetimi i mungesave.

Kryesuesi theksoi se arsyetim të mungesave ka vetëm për anëtarin Pal Berisha, i cili ka shkuar në Amerikë, për të tjerë nuk ka arsyetim.

**Pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së KPF-së.**

Kryesuesi hapi debatin rreth procesverbalit të seancës së kaluar.

Nuk pati debate.

Kryesuesi vuri në miratim procesverbalin e seancës së kaluar.

**Me vota unanime u miratua procesverbali i seancës së kaluar.**

**Pika e tretë: Shqyrtimi i Draft-buxhetit të Komunës së Klinës për vitin 2018-2010.**

Kryesuesi Ibishi foli rreth çështjes në shqyrtim. “Janë bërë të gjithë hapat e nevojshëm”, sqaroi kryesuesi, i cili në vijim fjalën e barti te zyrtarja e Drejtorisë për Financa, znj. Xufe Kelmendi.

**Xufe Kelmendi**, zyrtare e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, foli rreth Draft-buxhetit të Komunës së Klinës për vitin 2018-2010.

Zyrtarja Kelmendi, sqaroi se Draft - buxheti i Komunës së Klinës sipas kategorive të shpenzimeve për periudhën 2018 – 2020: paga dhe mëditje, 5,733,598 euro; mallra dhe shërbime, 869,878 euro, komunalit, 151,258 euro; transefere dhe sub. 65,767; kapitale, 2,668,202 euro, totali: 9,488,703 euro.

Projektet që u janë dhënë përparësi nuk do të thotë se të tjera nuk do të përfshihen. Janë të mirëseardhura propozimet nga KPF, debatet me publikun, të cilat do të inkorporoheshin në raportin përfundimtar. Këto projekte nuk do të thotë se janë përfundimtare”, sqaroi ndër të tjera zyrtarja Kelmendi.

Kryesuesi hapi debatin rreth Draft-buxhetit.

**Fadil Gashi**, tha se ju bashkohem falënderimeve tuaja që është seance e fundit të këtij legjislativi. “Kemi bërë përpjekje të japim kontributin tonë brenda mundësive që kemi pasur në marrjen e vendimeve, thirrjen e interpelancave etj. Projektet janë të pranueshme, janë të mira, sepse janë në të mirë të qytetarëve tanë. 40 mijë euro për shëndetësi, mendoj që kjo shumë për këtë segment është pak. Duhet përkrahur edhe fusha të tjera, jo të investohet vetëm në rrugë dhe asfalt. Kemi diskutuar shumë herë. Nuk po kemi mundësi për ta sanuar gjendjen. Tonat janë edhe shëndetësia, edhe bujqësia, edhe arsimi etj. Po fokusohemi kah po shtrohen ato rrugë, nuk po fokusohemi në asnje fushëveprimitari tjetër”, shtoi anëtari Gashi.

**Skënder Meturi**, shprehu falënderimin për të gjithë anëtarët e KPF-së për angazhimin dhe kontributin që kanë dhënë gjatë këtyre viteve në KPF. “Kemi bërë përpjekje që proceset t’i

shpijmë përpara. Sa i përket këtyre projekteve që figurojnë në këtë draft-buxhet, mendoj se janë projekte të fushatës. Zor kanë për t'u realizuar, është bërë pér t'i kërkuar votat. E kisha quajtur "buxhet zgjedhor" pér të fituar partia në pushtet, PDK. Shëndetësia është në gjendje të keqe, nuk i është dhënë përparësi. Kam një propozim konkret, që prej "Premarketi"t deri te Ura e magjistrale Pejë - Prishtinë të bëhet ndriçimi i rrugës", theksoi anëtar Merturi.

**Haxhi Ibishi**, foli rreth buxhetit, duke u fokusuar në prioritetin që duhet dhënë segmentit të shëndetësisë dhe të arsimit. "Do të kishte qenë mirë pér t'u planifikuar buxheti pér aftësimin profesional të këtyre dy sektorëve. Të buxhetohet pér profesionalizmin dhe ngritjen profesionale të kuadrove të këtyre dy segmenteve. Drejtori pér Shëndetësi të përgatit një program shtesë. Të bëhet një analizë në shëndetësi. Të punohet në përmirësimin e gjendjes në shëndetësi. Profesionalistët e kanë fjalën e tyre. Jemi para një sfide. Ky buxhet është si copy paste i buxheteve të kaluar. Në krejt këtë propozim ekzekutivi të vlerësojë edhe një herë. Në shëndetësi të ndryshojë gjendja, përkatesisht buxheti të shtohet. Ekzekutivi le ta shoh a ka mundësi pér të bërë ndonjë hap në këtë drejtim", ka konstatuar kryesuesi Ibishi.

**Baki Gashi**, drejtor i Urbanizmit, falënderoi anëtarët e KPF-së pér bashkëpunimin. Drejtori Gashi, në vijim po ashtu prezantoi disa gabime teknike që janë lëshuar te evidencimi i projekteve. "Pas daljes në terren do të evidencojet projektet", tha drejtori Gashi.

**Halil Desku**, përshëndeti dhe falënderoi anëtarët e KPF-së pér bashkëpunimin gjatë këtyre viteve të kësaj legjislature. "Do të dominojë fryma e optimizmit që të ecet përpara", shtoi prof. Desku, i cili duke folur pér buxhetin, pohoi se ky buxhet nuk ka konotacion politik Janë kryer shumë projekte. Ka shumë edhe të punohet në infrastrukturën shkollore, në bujqësi, shëndetësi etj. Nuk është buxhet që shkon pér fushatë elektorale. Është vazhdimësi buxhetore e projekteve të tjera. Me këtë buxhet po ofrojmë përfundimin e investimeve në krye me kryetarin e Komunës, z. Sokol Bashota.

**Ndue Shabanaj**, tha se nuk do të lëshohem në detaje. "Falënderoj kolegët pér të gjitha format e bashkëpunimit. Ka pasur raste që nuk jemi pajtuar, mirëpo ka shkuar në zhvillimin e Komunës. Ka disa fshatra as që është filluar, as që është realizuar asnjë projekt. Ka fshatra që janë realizuar shumë projekte, në disa asnjë! Kjo dëshmon pér qasje jo proporcionale. Gjithmonë kam potencuar që kjo të merret parasysh, që balancimi i projekteve të jetë prioritet. Të përfundohen 17 vite dhe të ketë një fshat që nuk ka realizuar asnjë projekt, konsideroj që nuk është në rregull. Është një moskujdes i pushtetit lokal. Jam pér atë pér t'u respektuar debate me publikun dhe propozimet që vijnë nga qytetarët, mirëpo propozimet e tyre të mos janë përcaktuese. Esenciale pér mua është orientimi racional i investimeve të projekteve nga ana e pushtetit lokal. Duhet pasur parasysh shpërndarjen e investimeve", ka konstatuar ndër të tjera profesor Shabanaj.

Enver Marmullaku, foli rreth pakënaqësisë pér politikën e projekteve në drejtorinë e Bujqësisë dhe të Zhvillimit Rural. "Nuk jam i kënaqur me projektet në Drejtorinë e Bujqësisë", shtoi drejtori Marmullaku, i cili në vijim potencoi disa projekte të cilat nuk janë paraparë pér t'u

realizuar në kuadër të kësaj drejtorie. “Jemi e vëtmja komunë në Kosovë që investojmë vetëm në kanale të ujitjes dhe në penda. Nga investimet kapitale është investuar në kanale të ujitjes dhe penda, por jo edhe në fusha të tjera, si në sera etj., që është hendikep i madh. Po kërkoj që bujqësisë t'i jepet prioritet më shumë”, shtoi ndër të tjera drejtori Marmullaku.

**Halil Desku**, kërkoi sqarim nga drejtori i Bujqësisë, z. Enver Marmullaku.

**Enver Marmullaku**, sqaroi interesimin e anëtarit Desku.

**Xufe Kelmendi**, sqaroi çështjen e ngrehur ne debat rrëth subvencioneve.

**Enver Marmullaku**, foli rrëth çështjes në debat.

Fadil Gashi, tha se u morëm vesh që të mos i japim konotacion politik. “Nuk di se si ka të drejtë për të investuar në kanale dhe pendë, e jo në fidanë. S’ë di cili auditor këtë të drejtë të projekteve ka mundësi të na e mohojë, kur projekt i kalon Kuvendin. Ata nuk na i ndërtojnë planifikimet. Kot i fut në letër, kur nuk i stimulon me buxhet”, ka shtuar anëtari Gashi.

**Xufe Kelmendi**, sqaroi dallimin në mes të investimeve në kanale dhe të serave. Në menaxhimin e financave ka rregulla. “Kufijtë i bën Ministria e Financave, nuk i bëjmë ne. ne nuk mund ta bëjmë ndryshimin në buxhet. Kufijtë nuk mund të ndryshojnë, nuk varen prej nesh”, sqaroi zyrtarja Kelmendi.

**Enver Marmullaku**, foli rrëth çështjes tematike. “Shumë projekte kanë mbetur pa investime”, sqaroi ai.

**Fadil Gashi**, tha se duhet investuar duke iu përshtatur specifikave të komunave. “Dragashi ka si prioritet blegtorenë dhe duhet investuar në këtë fushë. Prej pasluftës nuk kemi gjetur asnje konsensus të mirë të pagesës së komisioneve. Kur flasim me ministrinë ata thonë se nuk po i planifikoni me kohë”, shtoi anëtari Gashi.

**Halil Desku**, tha se buxhetit të mos i jepet konotacion politik dhe ka qenë gjithëpërfshirës. “Këtë buxhet ne kemi për ta realizuar. Komunat tjera kanë dhënë subvencione tjera, te ne s’po ndodh. Çfarë të bëjmë si komunë? S’jemi kundër pendëve, çfarë të bëjmë kur të kryhen pendët? Ju si Drejtori e Financave duhet punuar. Ke është edhe te bujqit, edhe te qytetarët”, ka vlerësuar profesor Desku.

**Ndue Shabanaj**, foli rrëth çështjes në debat. “Secili ka objektivin e vet për të arritur. “Nuk është mirë në këtë drejtim të mohohen faktet, këto nuk hidhen”, shtoi ndër të tjera prof. Shabanaj.

**Xufe Kelmendi**, sqaroi çështjet e ngrehura nga anëtarët. “Asnjë komunë prej investimeve kapitale nuk është duke investuar në subvencione. Pse nuk orientohen subvencionet në ato fusha është diçka tjeter. Komunat tjera i bëjnë kërkesat. Komunat kanë përfituar nga Ministria e Bujqësisë. Nuk mund të subvencionohet prej kapitaleve”, sqaroi zyrtarja Kelmendi.

**Enver Marmullaku**, foli rrëth çështjes në debat, përkatësisht rrëth subvencioneve në bujqësi. “Komunat nuk kanë të drejtë për të aplikuar në projekte, për të aplikuar në projekte kanë të drejtë fermerët. Që nga viti i kaluar ka ndryshuar forma e të aplikuarit”, shtoi drejtori Marmullaku.

**Haxhi Ibishi**, tha se është e nevojshme të harmonizohen qëndrimet në mes të DF dhe DBZHR.

Vuri në miratim rekomandimin.

**Me vota unanim u miratua rekomandimi.**

**Pika e katërt: Shqyrtimi i Projekt – rregullores për varreza, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre.**

Kryesuesi foli rrëth projekt-rregullores. Hapi debatin. Nuk pati debate.

Kryesuesi projekt-rregulloren e vuri në miratim

**Me vota unanim u miratua Projekt – rregullorja për varreza, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre.**

Kryesuesi informoi anëtarët e KPF-së rrëth panove me emrat e anëtarëve të KK për të gjitha legjislaturat dhe mirënjojjeve që do të ndahen nga ana e kryesuesit të KK për anëtarët e KK.

Seancën e konstataoi të mbyllur.

Seanca përfundoi në orën 11.45 minuta.

Procesmbajtësi,  
Mikel GOJANI

*mikel*

